



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.01.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4290/15, për zyrtarin e lartë z. Isuf Jashari, Drejtor në Komunën e Vushtrrisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshëm të Konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokollit AKK-03-02-4290/15, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Isuf Jashari, Drejtor në Komunën e Vushtrrisë .**

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konfliktit të mundshëm të interesit është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë z. Isuf Jashari, Drejtor në Komunën e Vushtrrisë. Është vërejtur se zyrtari i lartë z. Isuf Jashari ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si person i autorizuar në këtë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrim të funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.11.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Isuf Jashari, ka ardhur në zyrat tona ku nga zyrtarët ngarkuar me rastin është njoftuar për situatën në të cilën gjendet si dhe me provat dhe faktet që posedon AKK-ja.



Gjatë takimit të organizuar zyrtari është pajtuar me gjendjen por na ka njoftuar se për biznesin në fjalë ka bërë kërkesë për shuarje, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të sjell dëshmitë lidhur me këtë biznes.

Duke parë që zyrtari po vonohet në sjelljen e dokumenteve për ndryshimet e kërkuara në biznes i kemi dërguar edhe shkresën e dytë paralajmëruese sipas nenit 18.5 të Ligjit Nr.04/L- 051.

Me datën 18.01.2016, nga z. Isuf Jashari, Drejtor në Komunën e Vushtrrisë, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se biznesi me emër N.SH "Q&J" me nr.70518139 është shuar në mënyrë vullnetare.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Isuf Jashari, Drejtor në Komunën e Vushtrrisë dukë bërë shuarjen vullnetare në biznesin privat janë krijuar rrethana të reja dhe konstatojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

